

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Janar 2024

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në edicionin e këtij Buletini pasqyrohen
aktivitetet e KPK-së për muajin janar të vitit
2024)

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Janar 2024

Rritja e numrit të prokurorëve, nevojë e domosdoshme për sistemin prokurorial të vendit, vlerësojnë anëtarët e Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Prishtinë, 4 janar 2024

Komisioni për Administrimin e Prokurorive i Këshillit Prokurorial të Kosovës mbajti takim të parë për vitin 2024, me ç'rast diskutoi për numrin e prokurorëve në sistemin prokurorial, Draftplanin e Punës për vitin 2024 dhe Draftraportin e Punës së Komisionit për vitin 2023.



Anëtarët e Komisionit vlerësuan se, rritja e numrit të prokurorëve është nevojë e domosdoshme për sistemin prokurorial të vendit. Ata theksuan se ende ka ngarkesë në punën e secilit prokurorë për shkak të numrit të madh të lëndëve.

Për Draftplanin e Punës së Komisionit për vitin 2024, u potencua se nevojitet përfshirja e vlerësimit të objektivave të përcaktuara, strategjitë e parashikuara dhe masat konkrete për të arritur këto objektiva, kurse Draftraporti i punës për vitin 2023 të përfshijë vlerësimin e arritjeve të komisionit, sfidat e hasura dhe rekomandimet e nxjerra për të ardhmen.

Komisioni për Administrimin e Prokurorive miratoi Raportin analitik për numrin e prokurorëve dhe pozitave të lira në sistemin prokurorial

Prishtinë, 10 janar 2024

Komisioni për Administrimin e Prokurorive trajtoi dhe miratoi Raportin analitik për numrin e prokurorëve dhe pozitave të lira në sistemin prokurorial, në kuadër të një takimi tjetër, të mbajtur gjatë fillimjanarit të këtij viti.



Komisioni për Administrimin e Prokurorive, i udhëhequr nga Zëvendëskryesuesi Veton Shabani, njoftoi se, do ta dërgojë Raportin analitik me propozime në KPK për numrin e nevojshëm të prokurorëve në sistemin prokurorial, propozim ky, që do t'i hapë rrugë rekrutimit të prokurorëve të rinj.

Fuqizimi i administratës së sistemit prokurorial, në fokus të takimit të parë njohës të Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së me përfaqësuesit e Zyrës së BE-së në Kosovë

Prishtinë, 10 janar 2024

Në takimin e parë njohës të zhvilluar ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së, z.Sami Istrefi, me përfaqësuesit e Zyrës së BE-së në Kosovë, u diskutua për vazhdimin e koordinimit të veprimeve dhe adresimin e çështjeve që ndikojnë në rritjen dhe fuqizimin e administratës së sistemit prokurorial.

Rrjedhimisht, Drejtori Istrefi falënderoi për bashkëpunimin e derisotëm dhe kërkoi intensifikimin e tij në të ardhmen për fuqizimin e kapaciteteve administrative të sistemit prokurorial.

Me këtë rast, z.Istrefi kërkoi përkrahjen e mëtejshme të Zyrës së BE-së në aktivitetet e planifikuara për vitin

2024, të cilat ndërlidhen me përmirësimin e cilësisë së shërbimeve administrative.



Përfaqësuesit e Zyrës së BE-së, thanë se bashkëpunimi do të vijojë, ashtu siç është paraparë në kuadër të projekteve të sektorëve përkatës të Zyrës së BE-së dhe projekteve të ndryshme për sistemin e drejtësisë.

Hartimi i manualit për profesionistët në fushën e gjyqësorit dhe prokurorisë, temë diskutimi e Kryesuesit të KPK-së me ekspertët ligjorë të GIZ-it

Prishtinë, 10 janar 2024

Gjatë takimit të zhvilluar ndërmjet Kryesuesit Maloku dhe ekspertëve ligjorë të projektit të GIZ-it për mbështetje për proceset e reformës së integritetit të Kosovës në BE, u diskutua për hartimin e manualit për profesionistët në fushën e gjyqësorit dhe prokurorisë.



Kryesuesi i KPK-së Maloku, tha se mirëpret hartimin e këtij manuali, i cili do të ofrojë skenarë të ndryshëm për çështje të ndryshme ligjore dhe do të jetë i përshtatshëm për të ndihmuar në trajtimin e çështjeve që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale.

Sipas ekspertëve ligjorë të Projektit të GIZ-it, manuali siguron një bazë të fortë referimi për gjyqtarët dhe prokurorët për të ndihmuar në vendimmarrjen e përgjegjshme dhe për të garantuar që përpunimi i të dhënave personale në proceset gjyqësore dhe prokuroriale të jetë në përputhje të plotë me ligjet aktuale dhe standardet më të larta etike dhe profesionale.

Kryesuesi Maloku diskuton më përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane për jetësimin e aktiviteteve të planifikuara vjetore

Prishtinë, 11 janar 2024

Në kuadër të bashkërendimit të aktiviteteve të përbashkëta në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë, Kryesuesi i KPK-së zhvilloi një takim me Këshilltarin Rezident Ligjor në Ambasadën Amerikane në Kosovë dhe Zyrtares e Lartë Ligjore në OPDAT.



Jetësimi i aktiviteteve të planifikuara vjetore për këtë vit, që ndërliiden me forcimin e zbatimit të ligjit në Kosovë, ishte temë e diskutimit të tyre.

Natyrisht se gjatë takimi të zhvilluar, Kryesuesi i KPK-së, z.Jetish Maloku, shprehu falënderimin e tij për angazhimin e pakursyer të Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë në aspektin e ofrimit të ndihmës për fuqizimin e sistemit prokurorial.

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit pret në takim përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane

Prishtinë, 11 janar 2024

Në kuadër të takimeve njohëse dhe zhvillimeve të diskutimeve për bashkërendimin e aktiviteteve të përbashkëta me partnerët ndërkombëtarë, Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së ka pritur në takim Këshilltarin Rezident Ligjor në Ambasadën e SHBA-së, Erin Cox

dhe Zyrtares e Lartë Ligjore në OPDAT në Ambasadën Amerikane, Benina Kusari.



Ai falënderoi përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane për vizitën, duke theksuar se është në interes të plotë të Sekretariatit që ai përfaqëson të vazhdojë bashkëpunimi i ngushtë për fuqizimin e kapaciteteve administrative të sistemit prokurorial.

Bashkëbiseduesit folën edhe për çështjet e prioriteteve dhe organizimit të punëve të përbashkëta, identifikimin dhe planifikimin e saktë të tyre dhe tejkalimin e sfidave në rrugën përpara, me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe llogaridhënies së njësisë organizative dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve administrative, ndër të tjera, u diskutua edhe çështja e mbështetjes së kapaciteteve të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave dhe krijimin e kushteve për punë sa më efektive të mbrojtësve të viktimave.

Këshilltari Rezident Ligjor në Ambasadën e SHBA-së uroi Drejtorin e Përgjithshëm për detyrën e re dhe shprehu gatishmërinë për të mbështetur dhe përkrahur administratën në realizimin e misionit të përcaktuar, me anë të ekspertizës dhe formave të tjera, në mënyrë që të ketë fuqizim të mëtejshëm të kapaciteteve administrative të sistemit prokurorial.

Drejtori i SKPK-së: Do të ofrojmë mbështetje për forcimin e kapaciteteve të mbrojtësve të viktimave

Prishtinë, 12 janar 2024

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, Sami Istrefi, ka zhvilluar një takim pune me Ushtruesin e Detyrës së Menaxherit të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, Burhan Maxhuni, për të diskutuar gjetjen e mënyrave dhe formave për ofrimin e mbështetjes në fuqizimin dhe ngritjen e kapaciteteve, si dhe identifikimin e sfidave dhe tejkalimin e tyre në fushën e përfaqësimit të interesave të viktimave dhe ofrimit të shërbimeve për viktimat e krimit gjatë procedurave ligjore të

mbrojtësve të viktimave në prokuroritë dhe gjykatat e vendit.



Këto diskutime shprehin përkushtimin e përbashkët për të parë më qartë dhe në perspektivë mbështetjen administrative që do t'i ofrohet ZMNV-së dhe trupave të saj, ka potencuar Drejtori I Përgjithshëm, duke njoftuar se tashmë është në proces Plotësimi dhe Ndryshimi i Rregullores për Mandatin, Strukturën, Funksonimin dhe Organizimin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, e cila do të ndikojë në avancimin e veprimtarisë dhe resurseve të nevojshme dhe krahas kësaj do të kemi në vëmendje edhe shtimin e veprimeve administrative për të jetësuar konkretisht fuqizimin dhe ngritjen e kapaciteteve të këtij institucioni prokurorial dhe përgjithësisht për mbrojtësit e viktimave.

Hapet thirrja publike për nominimin e kandidatëve për Kryesuesit dhe Zëvendëskryesuesit të KPK-së dhe shpallet konkursi për rekrutimin e 28 prokurorëve të rinj

Prishtinë, 15 janar 2024

Këshilli i Prokurorial i Kosovës në Takimin e 240-të, të udhëhequr nga Kryesuesi Jetish Maloku, ka hapur thirrjen publike për nominimin e kandidatëve për pozitën e Kryesuesit dhe Zëvendëskryesuesit të Këshillit Prokurorial dhe ka shpallur konkursin për rekrutimin e 28 prokurorëve të rinj.

Në vijim gjeni të gjitha vendimet e KPK-së:

-miratoi Raportin për aktivitetet dhe rekomandimet e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik për periudhën korrik-shtator 2023;

-aprovoi kërkesën e prokurorit Shpëtim Peci për transferimin e tij nga Prokuroria Speciale në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë nga data 1 mars 2024;

- aprovoi dorëheqjen e prokurores Slavica Popovic nga Prokuroria Themelore në Gjiilan, për të cilën mori vendim që ta dërgojë propozimin tek Presidentja e vendit për lirim nga detyra;

-caktoi zëvendëskryeprokuroret e tri prokurorive, si në vijim: prokurorin Valdet Gashi në Prokurorinë Speciale, prokuroren Elza Bajrami në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe prokurorin Sadri Alija në Prokurorinë Themelore në Gjakovë;

-caktoi udhëheqësit e departamenteve në Prokurorinë Speciale, si vijon: prokurorin Ilir Morina, udhëheqës të Departamentit për Krime Luftë, prokurorin Afrim Shefkiu, udhëheqës të Departamentit për Terrorizëm dhe prokurorin Valdet Gashi, udhëheqës të Departamentit për Korrupsion dhe Krim Financiar, kurse caktimi i udhëheqësit të Departamentit për të Mitur në Prokurorinë Themelore në Prishtinë është shtyrë gjersa të përfundojë procedura për avancim në Prokurorinë Speciale;



-hapu konkursin për rekrutimin e 28 prokurorëve të rinj nga data 22 janar 2024;

-themeloi Komisionin për Rekrutimin e Prokurorëve dhe Komisionin për Rishqyrtim të Ankesave;

- hapu thirrjen publike për paraqitjen e nominimeve për kandidatët për pozitën e Kryesuesit dhe Zëvendëskryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, afati i dorëzimit të të cilave do të fillojë nga 16 janari 2024 dhe do të jetë e hapur tre ditë;

-trajtoi dy raporte të Komisionit për Vlerësimin e Performancës për vlerësimin e performancës dhe kundërshtimin e paraqitur nga një prokuror;

-mbajti një seancë dëgjimore disiplinore për rastin e një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, kurse vendimi do të nxjerrët siç parashihet me Ligj.

Diskutohet për cilësinë e të dhënave statistikore në sistemin prokurorial

Prishtinë, 16 janar 2024

Anëtarët e Komisionit për Administrimin e Prokurorive të Këshillit Prokurorial të Kosovës, së bashku me përfaqësuesit e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë (NJSHP) dhe Departamentin e Teknologjisë Informative në Sekretariatit e KPK-së, mbajtën një takim me ekspertët e CEPEJ-it, të cilët punojnë në kuadër të Projektit të KoSEJ III të Këshillit të Evropës, i cili ka të bëjë me forcimin e cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë.



Qëllimi i takimit është diskutimi për krijimin e kushteve që nevojiten për të garantuar cilësinë e statistikave të prokurorive të vendit, tha kryetari i Komisionit për Administrimin e Prokurorive të KPK-së, Veton Shabani, i cili përshëndeti ekspertet e CEPEJ-it për ofrimin e ndihmës në këtë drejtim dhe shprehu falënderimin e tij për ofrimin e bashkëpunimit konkret në kuadër të këtij projekti të Këshillit të Evropës në Prishtinë.

Rrjedhimisht, me tej, u tha se sistemi prokurorial është jashtëzakonisht i interesuar për të krijuar bazën e suksesit që ndërlidhet standardet dhe praktikave më të mira ndërkombëtare për mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore që dalin nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Lëndëve-SMIL.

Ekspertët e CEPEJ-it u fokusuan te besueshmëria e statistikave, duke thënë se suksesi i një sistemi prokurorial varet nga cilësia e futjes së të dhënave, kushteve të nevojshme që ofron për futjen e të dhënave në sistemet e krijuara, vendosjen e rregullave kombëtare të kodifikimit për standardizimin e metodave të përdorura për futjen e të dhënave, sepse, sipas tyre, futja e të dhënave duhet të paraprihet nga një përkufizim i parimeve të kodimit që do mund të zbatohen në mënyrë të përpiktë dhe uniforme nga anëtarët e caktuar të stafit, parime këto, që duhet të jenë të detyrueshme dhe të disponueshme në formë të shkruar.

Ajo që ishte me rëndësi gjatë diskutimeve ishte se, përveç transparencës që krijohet nga informacionet statistikore, përdorimi i statistikave të prokurorive të

vendit lehtëson veprimet e përmirësimit të cilësisë dhe efikasitetit të drejtësisë, duke përcaktuar orientimin të qartë në rrugën përpara dhe duke trajtuar kriminalitetin në mënyrë më efektive.

Rëndësia e raporteve të auditimit për përdorim efektiv, efikas dhe ekonomik të fondeve publike, ishte temë e diskutimeve ndërmjet Malokut dhe Spancës

Prishtinë, 17 janar 2024

Në kuadër të avancimit të bashkëpunimit ndërmjet Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, është mbajtur një takim, në të cilin pati diskutime për rëndësinë e raporteve të auditimit për përdorim efektiv, efikas dhe ekonomik të fondeve publike, si dhe për zbatimin e standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare gjatë proceseve të menaxhimit transparent të financave publike, ku morën pjesë Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, i shoqëruar nga Auditori i Brendshëm në Sekretariatit e KPK-së, Beqir Dauti dhe Auditorja e Përgjithshme e Republikës së Kosovës, Vlora Spanca dhe Zëvendësauditori i Përgjithshëm, Bezat Halilaj.



Kryesuesi Maloku informoi Auditoren e Përgjithshme për përpjekjet dhe angazhimin e sistemit prokurorial në përmirësimin e vazhdueshëm rreth menaxhimit të fondeve publike, duke u mbështetur në rekomandimet e auditorit të ZKA-së dhe rekomandimet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm të KPK-së.

Auditorja e Përgjithshme dhe Kryesuesi i KPK-së u pajtuan për nevojën e organizimit të trajnimeve të përbashkëta me prokurorë, me qëllim që të diskutohen dhe trajtohen rekomandimet e auditimit, duke theksuar përkushtimin e përbashkët për të punuar gjithnjë në interes të rritjes së përgjegjësisë publike në fushën e zbatimit të ligjit.

Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së: Çmohet lart bashkëpunimi i deritashëm dhe kërkohet avancimi i proceseve të përbashkëta në të ardhmen

Prishtinë, 17 janar 2024

Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, Sami Istrefi, priti në një takim njohës përfaqësueset e Sektorit të Sundimit të Ligjit në Ambasadën e Britanisë së Madhe në Prishtinë, Margaret Belof dhe Altina Besimi, qëllimi i të cilit ishte diskutimi për gjetjen e mënyrave për ofrimin e mbështetjes dhe bashkëpunimit të nevojshëm në proceset e ardhshme që kanë për qëllim tejkalimin i vështirësive dhe sfidave në administratën e sistemit prokurorial.



Drejtori i Përgjithshëm falënderoi Udhëheqësen e Sektorit të Sundimit të Ligjit në Ambasadën Britanike për kontributin e dhënë drejt avancimit të proceseve të administratës së sistemit prokurorial, duke kërkuar njëkohësisht përkrahjen e tyre të mëtejshme në aktivitetet e planifikuara për vitin 2024, kurse përfaqësueset e Ambasadës Britanike, theksuan se do të vazhdojë ky bashkëpunim, siç është parashikuar në kuadër të projekteve të përbashkëta dhe projekteve të tjera për sistemin e drejtësisë me anë të ofrimit të ekspertizës së nevojshme.

Kryesuesi i Komisionit për Administrimin e Prokurorive priti në takim Asistenten Ekzekutive të Zyrës së Prokurorit të Shteteve të Bashkuara për Qarkun Verior të Ilionis-it

Prishtinë, 25 janar 2024

Kryesuesi i Komisionit për Administrimin e Prokurorive, Veton Shabani, së bashku me anëtarin e Komisionit, Sevdije Morina, ka pritur në takim Asistenten Ekzekutive të Zyrës së Prokurorit të Shteteve të Bashkuara për Qarkun Verior të Ilionis-it, Meghan Morrissey, e cila shoqërohej nga Këshilltari Rezident

Ligjor në Ambasadën e SHBA-së në Kosovë, Erin Cox dhe Zyrtarja e Lartë Ligjore në OPDAT, Benina Kusari.



Me këtë rast, z. Shabani falënderoi znj. Morrissey për vizitën e saj, duke vlerësuar lart ndihmën dhe përkrahjen sistematike të Ambasadës së SHBA-së dhënë institucioneve prokuroriale në funksion të forcimit të sundimit të ligjit, si dhe e informoi atë për aktivitetet e Komisionit, me qëllim të ngritjes së efikasitetit të punës, ngritjen e kualitetit të të dhënave dhe digjitalizimin e punës në sistemin prokurorial me anë të përdorimit të SMIL-it, si dhe synimet e përgjithshme për avancimin e punës në prokuroritë e vendit.

Në takim po ashtu është diskutuar edhe për menaxhimin dhe performancën e prokurorive të vendit dhe për përbushjen efikase dhe efektive të detyrave të punës dhe përvetësimin e njohurive në lidhje me menaxhimin.

Miratohet Raporti Vjetor Financiar për vitin 2023, rezulton se KPK-ja ka realizuar 95.56% të buxhetit total

Prishtinë, 26 janar 2024

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga prokurorja Ariana Shajkovci, ka mbajtur një takim, në të cilin



anëtarët e Komisionit miratuan Raportin Vjetor Financiar për vitin 2023, nga i cili rezulton se Këshilli Prokurorial i Kosovës ka realizuar 95.56% të buxhetit total për të gjitha kategoritë ekonomike dhe programet buxhetore dhe pritjet janë që gjatë vitit 2024 të ketë realizim edhe më të madh të këtij buxheti, si dhe kanë miratuar Planin e Punës së Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel, pa ndonjë vërejtje dhe rekomandime shtesë.

Fillon hartimi i Planit të Integritetit të Sistemit Prokurorial (2024-2026)

Prishtinë, 26 janar 2024

Grupi Punues për hartimin e Planit të Integritetit të Sistemit Prokurorial për vitet 2024-2026 ka diskutuar për draftimin e Planit të Integritetit dhe për çështjet që



ndërlidhen me sigurimin efektiv të menaxhimit të integritetit, llogaridhënies publike dhe transparencës, si dhe për parimet e rezistencës institucionale ndaj cenimeve të integritetit në sistemin prokurorial.

Kryesuesi i Grupit punues, Hajdaraj, theksoi se, përmes Planit të Integritetit të Sistemit Prokurorial 2024-2026, synohet rritja e mundësive që sistemi prokurorial të arrijë objektivat e menaxhimit të integritetit, pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale dhe besimin e stafit dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që kërkohet nga sistemi prokurorial.

Anëtarët e Grupit punues caktuan prioritetet e punës, përfshirë hartimin e planit, përpilimin e pyetësorit gjithëpërfshirës dhe përpilimin e tabelave të rrezikut dhe adresimin e cënueshmërisë së integritetit.

Plani i integritetit është një dokument i brendshëm për të vlerësuar nivelin e integritetit brenda institucionit përkatës dhe ofron masa për menaxhimin e tij, duke shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet përbrenda

fushëveprimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit.

Kryesuesi i ri i KPK-së zgjidhet Ardian Hajdaraj dhe Zëvendëskryesuesja e re, Jehona Grantolli

Prishtinë, 30 janar 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës i udhëhequr nga Kryesuesi e deritashëm, Jetish Maloku, në Takimin e 241-të të KPK-së, pas prezantimit të kandidaturave të anëtarëve



të nominuar për pozitën e Kryesuesit dhe Zëvendëskryesuesit të ri, KPK-ja zgjodhi në mënyrë unanime z.Ardian Hajdarajn, anëtar i KPK-së nga radhët e Prokurorisë Themelore në Pejë, në pozitën e Kryesuesit dhe znj.Jehona Grantollin, anëtare e KPK-së nga radhët e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, në pozitën e Zëvendëskryesueses së Këshillit Prokurorial të Kosovës.



Z.Hajdaraj dhe znj.Grantolli janë zgjedhur me mandat dyvjeçar, kurse zgjedhjes së tyre u ka paraprirë hapja e thirrjes publike më 15 janar 2024 për nominimin e Kryesuesit dhe Zëvendëskryesuesit të Këshillit Prokurorial.

Pas marrjes së detyrës se re, z.Hajdaraj kryesoi pjesën e mbetur të takimit, me ç'rast falënderoi për kontributin dhe përkushtimin e Kryesuesit dhe

Zëvendëskryesuesit të derisotëm të Këshillit, z.Jetish Maloku dhe z.Veton Shabani, duke theksuar se gjatë mandatit të tyre kanë avancuar proceset gjithëpërfshirëse të veprimtarisë së sistemit prokurorial.

Më pastaj, anëtarët e Këshillit, votuan edhe për zgjedhjen e kryesuesve dhe anëtarëve të rinj të Komisioneve të Përhershme të KPK-së, me ç'rast me votim unanimit u zgjodhën z.Jetish Maloku në pozitën e Kryesuesit të Komisionit për Administrimin e Prokurorive dhe z.Veton Shabani në pozitën e Kryesuesit të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve.

Avancimi dhe intensifikimi i komunikimit publik, prioritetet e kreut të administratës së sistemit prokurorial

Prishtinë, 31 janar 2024


Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Sami Istrefi, mbajti një takim me zyrtarët e shërbimit të komunikimit publik në sistemin prokurorial, në të cilin mori pjesë edhe Shefi i Kabinetit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z.Ardian Nikolla.

Qëllimi i takimit ishte diskutimi për avancimin, intensifikimin dhe krijimin e një qasjeje të re të komunikimit me mediat dhe publikun në sistemin prokurorial të Kosovës.



Me këtë rast, Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, duke shpalosur prioritetet dhe objektivat që kanë të bëjnë me fushën e komunikimit publik, theksoi nevojën që sistemi prokurorial të fuqizojë transparencën nëpërmjet një komunikimi më proaktiv dhe më gjithëpërfshirës me mediat dhe shoqërinë civile, duke iu përshtatur nevojave dhe kërkesave të kohës, sepse një qasje e tillë është e domosdoshme për ngritjen dhe përmirësimin e besueshmërisë dhe perceptimit të publikut për sistemin prokurorial në përgjithësi.

Po në këtë takim, zyrtarët për komunikim publik paraqiten sfidat dhe nevojat, të cilat i kanë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare në funksion të informimit të publikut me punën e Prokurorit të Shtetit.



Në këtë drejtim, kreu i administratës së sistemit prokurorial, ka shprehur mbështetjen e tij të plotë për punën dhe angazhimin e zyrtarëve për komunikim publik në sistemin prokurorial, njëkohësisht, ka theksuar gatishmërinë e tij që brenda mundësive ligjore dhe buxhetore t'i adresojë të gjitha sfidat me të cilat përballen këta zyrtarë, në mënyrë që kushtet e tyre të punës të përmirësohen dhe që komunikimi me publikun të jetë në nivelin sa më profesional.

Aktivitetet e Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (SKPK)

Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së përgjatë muajit janar 2024 ishin të ndërlidhura me proceset, si vijojnë:

- takimet e zhvilluara të Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së, Sami Istrefi, nëpër prokuroritë e vendit, me qëllim të identifikimit të çështjeve që kanë të bëjnë me ngritjen dhe avancimin e proceseve administrative dhe të sfidave dhe vështirësive që dalin në rrugën përpara;
- takimet e zhvilluara të Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së, Sami Istrefi, me partnerët ndërkombëtarë, me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve të përbashkëta dhe identifikimin e çështjeve të bashkëpunimit në të ardhmen që ndikojnë në avancimin e proceseve administrative;
- takimi i zhvilluar i Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së, Sami Istrefi, me zyrtarët për komunikim publik për avancimin dhe intensifikimin e komunikimit publik në sistemin prokurorial dhe nxjerrja e konkluzioneve për implementim, të cilat kanë të bëjnë me

- krijimin e një qasje të re në raport me mediat dhe publikun;
- zbatimin e mbështetjes për masat legjislative në kuadër të Programit Kombëtar për Integrim Evropian për vitin 2023;
 - Raportimi i të dhënave përfundimtare, nga të cilat rezulton se KPK-ja ka përmbyllur vitin 2023 me një përqindje të ekzekutimit të buxhetit për 95.6%;
 - hartimi i Raportit analitik-krahasimor për prokurorët me mandat të përhershëm, të vlerësuar përgjatë viteve 2021-2023 në kuadër të ciklit përmbyllës trevjeçar, sipas Rregullores 05/2020 për Vlerësimin e Performancës;
 - takimet e organizuara me anëtarët e Grupit punues për monitorimin e zbatimit të SMIL-it dhe prezantimi i Pyetësorëve për SMIL;
 - diskutimet e zhvilluara me përfaqësuesit e Projektit GIZ për sigurinë e të dhënave personale të palëve të regjistruara në Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve dhe me ekspertët e CEPEJ-it për cilësinë e të dhënave statistikore;
 - mbajtjen e trajnimeve për përdoruesit e platformës për korrupsion të nivelit të lartë, krim të organizuar dhe shpëlarje të parasë, i organizuar nga TAIEX -Komisioni Evropian;
 - limplementimi i sistemit operativ të platformës së Windows-it në mënyrë automatike për tërë stafin e sistemit prokurorial në bashkëpunim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit;
 - finalizimi i shtojcave për zbatimin e Rregullores Nr.06.2023 për Qasje në Dokumente Publike, me ç'rast janë përgatitur shtojcat: Formulari i kërkesës për qasje në dokumente publike dhe formatet e vendimeve për lejimin e qasjes, refuzimin dhe qasjen e pjesshme në dokumente publike të KPK-së dhe PSH-së;
 - hartimi i draftit të Planit të Integritetit në sistemin prokurorial të Kosovës dhe hartimi i raportit vjetor të sistemit prokurorial për kërkesat për qasje në dokumente publike gjatë vitit 2023 në Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP), i cili është publikuar në rubrikën Transparenca në uebportalin aktual.